

32001R0070

Rregullore e Komisionit (KE) nr. 70/2001 datë 12 janar 2001, në zbatim të neneve 87 dhe 88 të Traktatit të BE-së mbi ndihmën shtetërore për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

Gazeta Zyrtare L 010, 13/01/2001 fq.0033-0042

Rregullore e Komisionit (KE) nr. 70/2001 datë 12 janar 2001, në zbatim të neneve 87 dhe 88 të Traktatit të BE-së mbi ndihmën shtetërore për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

KOMISIONI I KOMUNITETEVE EUROPIANE

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit Europian,

Duke pasur parasysh Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 994/98 datë 7 maj 1998 në zbatim të neneve 92 dhe 93 të Traktatit Themelues të Komunitetit Europian, në vendosjen e disa kategorive të ndihmës shtetërore horizontale [1], dhe në veçanti neni 1 pika 1 geramat (a) nënpika (i) dhe (b) i saj,

Ka publikuar një projekt të kësaj rregulloreje [2],

Është konsultuar me Komitetin Këshillimor mbi Ndihmën Shtetërore,

Duke pasur parasysh se:

(1) Rregullorja (KE) nr. 994/98 autorizon Komisionin të deklarojë, sipas nenit 87 të Traktatit, që nën disa kushte ndihma për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme është në përputhje me tregun e përbashkët dhe nuk është subjekt njoftimi sipas nenit 88 pika 3 të Traktatit.

(2) Rregullorja (KE) nr. 994/98 gjithashtu autorizon Komisionin të deklarojë, në përputhje me nenin 87 të Traktatit, që ndihma e dhënë në përputhje me hartën e miratuar nga Komisioni për çdo Shtet Anëtar për dhënien e ndihmës rajonale është në përputhje me tregun e përbashkët dhe nuk është subjekt njoftimi sipas nenit 88 pika 3 të Traktatit.

(3) Komisioni ka aplikuar nenet 87 dhe 88 të Traktatit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme brenda dhe jashtë zonës së dhënë, në vendime të shumta dhe gjithashtu, ka caktuar politikat e tyre, më së fundi në direktivat e Komunitetit mbi ndihmën shtetërore për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme [3] dhe në direktivat mbi ndihmën rajonale kombëtare [4]. Duke marrë parasysh eksperiencën e konsiderueshme të Komisionit në aplikimin e këtyre neneve për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, dhe duke marrë parasysh tekste të ndryshme që lidhen me ndihmën për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe me ndihmën rajonale të nxjerra nga Komisioni në bazë të këtyre dispozitave, me synimin që të sigurojë kontrollin efikas dhe administrimin e thjeshtuar pa dobësuar fuqinë monitoruese të Komisionit, është e nevojshme që Komisioni të shfrytëzojë pushtetet referuar në Rregulloren (KE) nr. 994/98.

(4) Kjo rregullore nuk cenon të drejtën e Shteteve Anëtare për të njoftuar ndihmën për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Këto njoftime do të vlerësohen nga Komisioni, në veçanti, duke pasur parasysh kriteret e vendosura në këtë rregullore. Direktivat për ndihmën shtetërore për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme duhet të shfuqizohen, që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, meqenëse përmbajtja e tyre është zëvendësuar nga kjo rregullore.

(5) Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme luajnë një rol vendimtar në krijimin e vendeve të punës, më gjerësisht, veprojnë si një faktor nxitës i stabilitetit social dhe ekonomik. Megjithatë, zhvillimi i tyre mund të kufizohet nga defektet e tregut. Shpesh ato kanë vështirësi në marrjen e kapitalit apo kredisë, për shkak të natyrës së veçantë të disa tregjeve financiare dhe garancive të kufizuara që ato mund të jenë në gjendje të ofrojnë. Burimet e tyre të pakta mund të kufizojnë marrjen e informacionieve, veçanërisht të atyre që kanë lidhje me teknologjinë e re dhe tregjet potenciale. Për këto arsye, qëllimi i ndihmës së përjashtuar nga kjo rregullore duhet të jetë lehtësimi i zhvillimit të veprimtarive ekonomike të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, me kusht që kjo ndihmë të mos ndikojë negativisht në kushtet e tregtisë, si dhe në nivelin e interesit të përgjithshëm.

(6) Kjo rregullore përjashton ndihmat individuale që përmbushin të gjitha kërkesat e rregullores, si dhe çdo skemë ndihme, që parashikon se ndihmat individuale mund të jepen sipas skemës së ndihmës, bazuar në kushtet e dhëna në këtë rregullore. Për të siguruar kontrollin efikas dhe administrimin e thjeshtuar, pa dobësuar fuqinë monitoruese të Komisionit, që skemat e ndihmës dhe ndihmat individuale të jenë të përjashtuara, duhet të bëjnë referimin në nenet e rregullores.

(7) Kjo rregullore duhet zbatuar pa cenuar rregulla të veçanta, të përcaktuara në rregullore, dhe direktiva në lidhje me ndihmën shtetërore në sektorë të veçantë, sikurse ekzistojnë për ndërtimin e anijeve dhe nuk zbatohet për sektorët e bujqësisë dhe peshkimit dhe akuakulturës.

(8) Me qëllim që të eliminojë ndryshimet që mund të shtrembërojnë konkurrencën, për të lehtësuar bashkërendimin ndërmjet Komunitetit dhe nismave kombëtare, për sa u përket ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe për qartësi administrative dhe siguri ligjore, përkufizimi “ndërmarrje të vogla dhe të mesme” i përdorur në këtë rregullore duhet të jetë po ai i përdorur në Rekomandimin e Komisionit 96/280/KE datë 3 prill 1996 [5]. Ky përkufizim është përdorur gjithashtu edhe në direktivat e Komunitetit për ndihmën shtetërore për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme [6].

(9) Në përputhje me praktikën e përcaktuar të Komisionit dhe me synimin që të sigurojë që ndihma është proporcionale dhe e kufizuar në masën e nevojshme, kufijtë duhet të shprehen në formën e intensitetit të ndihmës të përcaktuar mbi bazën e kostove të pranueshme dhe jo në bazë të vlerës më të lartë të ndihmës.

(10) Për të përcaktuar nëse ndihma është ose jo në përputhje me tregun e përbashkët, në vijim të kësaj rregulloreje është e nevojshme të merret në konsideratë intensiteti i ndihmës dhe, si rrjedhim, masa e ndihmës së shprehur si grant i barasvlefshëm. Llogaritja e grantit të barasvlefshëm fitimprurës në disa këste, dhe ndihma në formën e kredive të buta, kërkon përdorimin e normave të interesit të tregut ekzistues në kohën e grantit. Për zbatim të njëtrajtshëm, transparent dhe të thjeshtë të rregullave të ndihmës shtetërore, normat e interesit të tregut, sipas kësaj rregulloreje, duhet të jenë norma referencë, me kusht që, në rastin e kredive të buta, kthimi i kredisë të jetë i garantuar dhe të mos përfshijë një risk jashtë atyre të zakonshëm. Norma referencë janë ato që janë caktuar periodikisht nga Komisioni në bazë të kriterëve objektive, janë shpallur në Gazetën Zyrtare të Komunitetit European, si dhe në internet.

(11) Duke pasur parasysh ndryshimet midis ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, është vendosur intensiteti maksimal i ndihmës për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

(12) Intensiteti maksimal i ndihmës duhet të përcaktohet, duke marrë parasysh përvojën e Komisionit, për të ruajtur balancimin e duhur midis minimizimit të shtrembërimit të konkurrencës në sektorët ku jepet ndihma, dhe qëllimit për të lehtësuar zhvillimin e veprimtarive ekonomike të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

(13) Është e nevojshme të vendosen kushte të tjera që duhet të përmbushen nga çdo skemë ndihme ose ndihmë individuale, të përjashtuara nga kjo rregullore. Duke patur parasysh nenin 87 pika 3 germa (c) të Traktatit, këto ndihma normalisht nuk duhet të kenë një efekt të veçantë në reduktimin e vazhdueshëm apo periodik të kostove operative që duhet të sigurojë përfituesi, si dhe duhet të jenë në përpjestim të drejtë me mangësitë që kërkojnë të rregullojnë, duke siguruar fitime ekonomiko-shoqërore në interes të Komunitetit. Për këtë arsye, fusha e zbatimit të kësaj rregulloreje duhet të kufizohet në dhënien e ndihmës në lidhje me disa investime të prekshme dhe të paprekshme, me disa shërbime plotësuese të përfituesit dhe me disa aktivitete të tjera. Duke marrë parasysh kapacitetet e tepërta të Komunitetit në sektorin e transportit, përveç inventarit të hekurudhës, kostot e investimeve të prekshme në ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në sektorin e transportit nuk duhet të përfshijnë mjetet dhe pajisjet e transportit.

(14) Kjo rregullore duhet të japë ndihmë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, pavarësisht nga pozicioni ku ndodhen. Investimi dhe krijimi i vendeve të reja të punës mund të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të rajoneve më pak të favorizuara të Komunitetit. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në këto rajone vuajnë si nga mangësitë strukturore të pozicionit ku ndodhen, ashtu edhe nga vështirësitë që vijnë për shkak të madhësisë së tyre. Për këtë arsye, është e nevojshme që ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në rajonet e ndihmuara, të kenë nivele të larta përfitimi.

(15) Me qëllim që faktori kapital i një investimi të mos ketë përparësi mbi faktorin punë, dispozitat duhet të parashikojnë mundësinë e matjes së ndihmës për investime, nëse kostot e investimit ose kostot e vendeve të reja të punës lidhen me zbatimin e projektit të investimit.

(16) Duke marrë parasysh Marrëveshjen e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) mbi subvencionet dhe masat kundërpeshuese [7], kjo rregullore nuk duhet të përjashtojë ndihmën për eksport ose ndihmën që favorizon produktet e brendshme kundrejt atyre të importuara. Ndihma për çmimin e pjesëmarrjes në ekspozita tregtare, ose për studim apo shërbime konsultative që nevojiten për hedhjen në treg të një produkti të ri apo ekzistues, normalisht, nuk përbën ndihmë për eksport.

(17) Duke marrë parasysh nevojën për të vendosur ekuilibrin midis minimizimit të shtrembërimit të konkurrencës në sektorin ku është dhënë ndihma dhe objektivave të kësaj rregulloreje, nuk duhet të përjashtohet dhënia e ndihmës individuale që kalon kufirin maksimal të sasisë së caktuar, të bazuar ose jo në skemën e ndihmës së përjashtuar nga kjo rregullore.

(18) Me qëllim që të sigurojë që ndihma është e nevojshme dhe vepron si një incentivë në zhvillimin e disa veprimtarive, kjo rregullore nuk duhet të përjashtojë ndihmën për veprimtari, në të cilat përfituesi do të angazhohet, por vetëm sipas kushteve të tregut.

(19) Kjo rregullore nuk duhet të përjashtojë ndihmën e bashkuar me ndihma të tjera shtetërore, duke përfshirë edhe ndihmën e dhënë nga autoritete kombëtare, rajonale apo lokale, ose me asistencën e Komunitetit, në lidhje me kostot e pranueshme, kur një bashkim i tillë kalon kufirin e përcaktuar në këtë rregullore.

(20) Me qëllim që të sigurojë transparencën dhe monitorimin efektiv, sipas nenit 3 të rregullores (KE) nr. 994/98, është e nevojshme të vendoset një format standard, mbi bazën e të cilit Shtetet Anëtare duhet t'i paraqesin Komisionit informacion të përmbledhur, në zbatim të kësaj rregulloreje, në të gjitha rastet e zbatimit të skemave të ndihmës, apo të ndihmave individuale, të dhëna jashtë skemave.

Ky informacion botohet në Gazetën Zyrtare të Komunitetit European. Për të njëjtat arsye, është e nevojshme të vendosen rregulla në lidhje me regjistrimet që Shtetet Anëtare duhet të mbajnë për ndihmën e përjashtuar nga kjo rregullore. Me qëllim që nga ana Shteteve Anëtare të paraqitet raporti vjetor pranë Komisionit, është e nevojshme për Komisionin të vendosë kërkesat e caktuara prej tij, përfshirë këtu, kërkesën për informacionin në formë kompjuterike, duke pasur parasysh zgjerimin e mundësive për teknologji të tilla.

(21) Duke marrë parasysh përvojën e Komisionit në këtë fushë, dhe në veçanti, shpeshtësinë me të cilën është e nevojshme të rishikohet politika e ndihmës shtetërore, është e nevojshme të kufizohet perioda e zbatimit të kësaj rregulloreje. Nëse afati i kësaj rregulloreje nuk shtyhet, skemat e ndihmës të përjashtuara në bazë të kësaj rregulloreje, vazhdojnë të Jenë të përjashtuara edhe për 6 muaj pas afatit.

KA MIRATUAR KËTË RREGULLORE

Neni 1 Qëllimi

1. Kjo rregullore zbatohet për dhënien e ndihmës për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në të gjithë sektorët pa cenuar rregulloret ose direktivat e veçanta të Komunitetit, sipas Traktatit të Komunitetit European, që rregullojnë dhënien e ndihmës shtetërore në sektorë të veçantë, pavarësisht nëse janë më pak apo më shumë të kufizuara sesa kjo rregullore,.

2. Kjo rregullore nuk zbatohet për:

- (a) veprimtari të lidhura me prodhimin, përpunimin dhe marketingun e produkteve të regjistruara në Shtojcën I të Traktatit;
- (b) ndihmën në veprimtaritë e lidhura me eksportin, të quajtur ndryshe ndihmë e lidhur me sasinë e eksportuar, për ngritjen dhe zhvillimin e një rrjeti shpërndarjeje ose të shpenzimeve të tjera që lidhen me veprimtarinë e eksportit;
- (c) ndihmën që krijon përparësi për produktet e brendshme kundrejt atyre të importuara.

Neni 2 Përkufizime

Për qëllimin e kësaj rregulloreje:

- (a) “ndihmë” nënkupton çdo masë që përmbush të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 87 pika 1 të Traktatit;
- (b) “ndërmarrje të vogla dhe të mesme” nënkupton ndërmarrjet sipas përkufizimit në Shtojcën I;
- (c) “investime në asete të prekshme” nënkupton një investim në asete fizikisht të vendosura në krijimin e një ndërmarrjeje të re, zgjerimin e një ndërmarrjeje ekzistuese, ose përfshirjen në një veprimtari ku ka ndryshime të mëdha në një produkt ose procesin e prodhimit të një ndërmarrjeje ekzistuese (në veçanti nëpërmjet racionalizimit, diversifikimit ose modernizimit). Një investim në asete fikse i ndërmarrë në formën e transformimit të një ndërmarrjeje e cila është mbyllur ose është duke u mbyllur por nuk është blerë, duhet të konsiderohet gjithashtu si investime të prekshme.
- (d) “investime në asete të paprekshme” nënkupton investime në transferimin e teknologjisë nga përvetësimi i të drejtave të patentës, licensave, njohurive teknike ose njohurive teknike të pa licensuara;
- (e) “intesiteti bruto i ndihmës” nënkupton vlerën e ndihmës e shprehur si përqindje e kostove përkatëse. Të gjitha të dhënat e përdorura duhet të merren përpara zbritjes së taksimit të drejtëpërdrejtë. Kur ndihma nuk është dhënë në formë granti por në ndonjë formë tjetër, atëherë vlera e ndihmës do të jetë e grantit të barasvlefshëm të ndihmës. Ndhima e pagueshme në disa këste duhet të zbritet në vlerën e saj në momentin e dhënies. Norma e interesit që do të përdoret për zbritjen dhe

për llogaritjen e vlerës së ndihmës në formën e një kredie të zbutur do të jetë norma e referencës së përdorur në momentin e dhënies .

(f) “intesiteti neto i ndihmës” nënkupton vlerën e zbritur të ndihmës së shprehur si përqindje e kostove përkatëse;

(g) “numri i punonjësve” nënkupton numrin e njësisve vjetore të punës (NJVP), që do të thotë numri i personave të punësuar me kohë të plotë gjatë një viti. Personat e punësuar me kohë të pjesshme dhe ata sezonalë do të llogariten si fraksione të NJVP-ve;

Neni 3

Kushtet për përjashtim

Ndihma individuale jashtë skemave, që përmbush të gjitha kushtet e kësaj rregulloreje, do të jetë në përputhje me tregun e përbashkët në kuptimin e nenit 87 pika 3 të Traktatit dhe do të përjashtohet nga kërkesa për njoftim e nenit 88 pika 3 e Traktatit, me kusht që ajo të përmbajë një referencë të qartë në këtë rregullore, duke cituar titullin e saj dhe referencën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Komunitetit Europian.

Skemat e ndihmës që përmbushin të gjitha kushtet e kësaj rregulloreje do të jenë në përputhje me tregun e përbashkët sipas kuptimit të nenit 87 pika 3 të Traktatit dhe do të përjashtohen nga kërkesa për njoftim e nenit 88 pika 3 e Traktatit, me kusht që (a) çdo ndihmë që mund të jepet sipas kësaj skeme të përmbushë të gjitha kushtet e rregullores;

(b) skema të përmbajë një referencë të qartë në rregullore, duke cituar titullin e saj dhe referencën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Komisionit Europian

3. Ndihma e dhënë sipas skemave të referuara në paragrafin 2 do të jetë në përputhje me tregun e përbashkët në kuptimin e nenit 87 pika 3 të Traktatit dhe do të përjashtohet nga kërkesa për njoftim e nenit 88 pika 3 të Traktatit, me kusht që ndihma e dhënë në mënyrë të drejtpërdrejtë të përmbushë të gjitha kushtet e kësaj rregulloreje.

Neni 4

Investimi

1. Ndihma për investim në asete të prekshme dhe të paprekshme brenda dhe jashtë Komunitetit është në përputhje me tregun e përbashkët, sipas kuptimit të nenit 87 pika 3, përjashtohet nga kërkesa për njoftim sipas nenit 88 pika 3 të Traktatit, nëse përmbush kushtet e paragrafëve 2 deri 6.

2. Intensiteti bruto i ndihmës nuk duhet të kalojë:

(a) 15 % në rastin e ndërmarrjeve të vogla;

(b) 7,5 % në rastin e ndërmarrjeve të mesme.

3. Kur investimet bëhen në zonat të cilat janë kualifikuar për ndihmë rajonale, intensiteti i ndihmës nuk duhet të kalojë kufirin për ndihmën rajonale në investime, të përcaktuar në hartën e miratuar nga Komisioni për çdo Shtet Anëtar, me më shumë se:

(a) 10 përqind bruto në zonat e mbuluara sipas nenit 87 pika 3 germa (c), me kusht që totali i intensitetit neto të ndihmës të mos kalojë 30 %; ose

(b) 15 përqind bruto në zonat e mbuluara sipas nenit 87 pika 3 germa (a), me kusht që totali i intensitetit neto të ndihmës të mos kalojë 75 %.

Kufiri maksimal i ndihmës rajonale do të zbatohet, vetëm, nëse ndihma është dhënë me kushtin që investimi të ruhet për të paktën pesë vjet, në rajonin përkatës dhe që kontributi i përfituesit të jetë të paktën 25 %.

4. Kufiri i përcaktuar në paragrafët 2 dhe 3 duhet të zbatohet për intensitetin e ndihmës së llogaritur si përqindje e kostove të pranueshme të investimeve, ose si përqindje e kostove të pagave për vendet e punës të krijuara nga kryerja e një investimi (ndihma për krijimin e vendeve të reja të punës) ose një

kombinim i tyre, që parashikon që një ndihmë nuk kalon masën më të favorshme të rezultuara nga aplikimi i çdo llogaritjeje.

5. Në rastet kur ndihma është llogaritur në bazë të kostove të investimit, kostot e pranueshme të investimeve të prekshme duhet të jenë kostot që lidhen me investimet për tokën, ndërtesat, makineritë dhe pajisjet. Në sektorin e transportit, me përjashtim të inventarit hekurudhor, mjetet dhe pajisjet e transportit nuk duhet të përfshihen në kostot e pranueshme. Kostot e pranueshme për investimet e paprekshme duhet të jenë kostot e përvetësimit të teknologjisë.

6. Në rastet kur ndihma është llogaritur në bazë të krijimit të vendeve të reja të punës, masa e ndihmës duhet të shprehet në përqindjen e kostove të pagave për një periudhë prej më shumë se dy vjet duke u lidhur me krijimin e vendeve të punës sipas kushteve të mëposhtme:(a) krijimi i vendeve të reja të punës duhet të lidhet me zbatimin e një projekti investimi në asete të prekshme dhe të paprekshme. Vendet e punës duhet të krijohen brenda tre viteve nga përfundimi i investimit;
(b) projekti investimit duhet të ndiqet nga një rritje e numrit të punonjësve në ndërmarrjet përkatëse, duke u krahasuar me mesataren e dymbëdhjetë muajve të mëparshëm; dhe
(c) vendet e reja të punës duhet të mbahen për një periudhë minimale prej pesë vjetësh.

Neni 5

Këshillimi dhe shërbime e veprimtari të tjera

Ndihma për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që përmbushin kushtet e mëposhtme duhet të jetë në përputhje me tregun e përbashkët sipas kuptimit të nenit 87 pika 3 të Traktatit dhe duhet të përjashtohet nga kërkesa për njoftim sipas nenit 88 pika 3 të Traktatit:

- a) për shërbimet nga këshillime të jashtme, ndihma bruto nuk duhet të kalojë 50 % të kostove të këtij shërbimi. Këto shërbime nuk duhet të jenë veprimtari e vazhdueshme ose periodike, apo të lidhen me përdorimin e shpenzimeve operative të ndërmarrjes, siç është shërbimi për këshillime rutinë, shërbime të rregullta ligjore, ose reklamat;
- (b) për pjesëmarrjen në panairë dhe ekspozita, ndihma bruto nuk duhet të kalojë 50 % të kostove shtesë, që vijnë për shkak të qerasë, organizimit dhe funksionimit bazë. Ky përjashtim duhet të zbatohet vetëm për paraqitjen e parë të një ndërmarrjeje në një panair ose ekspozitë të veçantë.

Neni 6

Dhënia e masës së ndihmës

Kjo rregullore nuk përjashton dhënien e një ndihme individuale kur:

- (a) kostot e pranueshme totale për projektin në tërësi janë të paktën 25 000 000 EURO, dhe
 - (i) në zonat që nuk përfshihen për ndihmë rajonale, intensiteti bruto i ndihmës është të paktën 50 % e nivelit maksimal të parashikuar në nenin 4(2);
 - (ii) në zonat që përfshihen për ndihmë rajonale, intensiteti neto i ndihmës është të paktën 50 % e kufirit të ndihmës neto siç është parashikuar në hartën e ndihmës rajonale për zonat e sipërpërmendura; ose
- (b) masa totale bruto e ndihmës është të paktën 15 000 000 EURO.

Neni 7

Nevoja për ndihmë

Kjo rregullore përjashton ndihmën përpara se të fillojë puna për dhënien e ndihmës për projektin, vetëm nëse:

- ka patur një aplikim për ndihmë, paraqitur Shtetit Anëtar nga ana e përfituesit, ose

- Shtetet Anëtare kanë miratuar dispozita ligjore që parashikojnë të drejta ligjore për ndihmë, mbi bazën e kriterëve objektive dhe të papërcaktuara.

Neni 8 **Bashkimi**

Kufiri maksimal i ndihmës i parashikuar në nenin 4, 5 dhe 6 duhet të zbatohet në të gjitha rastet, pavarësisht nëse projekti financohet tërësisht nga burimet e shtetit ose pjesërisht nga Komuniteti.

Ndihma e përjashtuar nga kjo rregullore nuk duhet të bashkohet me ndonjë ndihmë tjetër shtetërore sipas kuptimit të nenit 87 pika 1 të Traktatit, ose me fonde të tjera të Komunitetit, për sa i takon kostove të pranueshme, nëse një bashkim i tillë rezulton më një intensitet ndihmë që kalon atë të parashikuar nga kjo rregullore.

Neni 9 **Transparenca dhe monitorimi**

1. Për zbatimin e një skeme ndihme, ose dhënien e ndihmës individuale jashtë skemave, të përjashtuara nga kjo rregullore, Shtetet Anëtare duhet që, brenda 20 ditëve pune, të paraqesin përpara Komisionit, një përmbledhje të informacionit për skemat e ndihmës ose ndihmat individuale, sipas formatit të parashikuar në Shtojcën II.

2. Shtetet Anëtare duhet të mbajnë të regjistruara të dhëna të hollësishme për skemat e ndihmës të përjashtuara nga kjo rregullore, ndihmën individuale të dhënë në bazë të atyre skemave, si dhe çdo ndihmë individuale, që gjen përjashtimin nga rregullorja, pavarësisht se është dhënë jashtë skemave ekzistuese të ndihmës. Rregjistrat e të dhënave duhet të përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm për të vendosur që kushtet për përjashtim, sipas kësaj rregulloreje, janë përmbushur, duke përfshirë informacionin mbi statusin e ndërmarrjes si NVM. Shtetet Anëtare duhet të mbajnë regjistrin për ndihmën individuale për 10 vjet nga data e dhënies së saj, dhe për skemat e ndihmës, për 10 vjet nga data e dhënies së ndihmës së fundit individuale, në bazë të skemës. Nëpërmjet një kërkesë me shkrim, Shtetet Anëtare të interesuara duhet t'i paraqesin Komisionit, brenda një periudhe prej 20 ditë pune ose brenda një periudhe më të gjatë, të caktuar në kërkesë, të gjithë informacionin që Komisioni e shqyrton si të nevojshëm për të vlerësuar nëse kushtet e kësaj rregulloreje janë plotësuar.

3. Shtetet Anëtare duhet të plotësojnë një raport për zbatimin e kësaj rregulloreje në lidhje me vitin kalendarik të plotë ose të pjesshëm, gjatë të cilit zbatohet rregullorja, në formën e parashikuar në Shtojcën III, si dhe në formë elektronike. Shtetet Anëtare duhet t'ia paraqesin këtë raport Komisionit jo më vonë se tre muaj nga përfundimi i afatit të periudhës, që mbulohet nga raporti.

Neni 10 **Hyrja në fuqi dhe periudha e vlefshmërisë**

1. Kjo rregullore hyn në fuqi njëzet ditë pas publikimit të saj në Gazetën Zyrtare të Komuniteteve Europiane.

Ajo do të mbetet në fuqi deri më 31 dhjetor 2006.

Në fund të periudhës së vlefshmërisë të kësaj rregulloreje, skemat e ndihmës të përjashtuara në bazë të kësaj rregulloreje do të mbeten të përjashtuara përgjatë periudhës së përshtatjes prej gjashtë muajsh.

Kjo rregullore është e detyrueshme në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejtë e zbatueshme në të gjitha Shtetet Anëtare.

Hartuar në Bruksel, më 12 janar 2001.

Për Komisionin

Mario MONTI

Anëtar i Komisionit

[1] GZ L 142, 14.05.1998, fq. 1.

[2] GZ C 89, 28.03.2000, fq. 15.

[3] GZ C 213, 23.07.1996, fq. 4.

[4] GZ C 74, 10.03.1998, fq. 9.

[5] GZ L 107, 30.04.1996, fq. 4.

[6] Shiko shënimin 3.

[7] GZ L 336, 23.12.1994, fq.156.

SHTOJCA I

Përkufizimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

(pjesë e marrë nga Rekomandimi i Komisionit nr. 96/280/KE, datë 3 prill 1996, në lidhje me përkufizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (GZ L 107, 20.04.1996, fq. 4)

'Neni 1

1. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, quajtur më poshtë "NVM-të", përkufizohen si ndërmarrje që:

- kanë më pak se 250 punonjës, dhe
- kanë ose,
një xhiro vjetore që nuk kalon 40 milionë Euro, ose
një bilanc vjetor që nuk kalon 27 milionë Euro,
- është në përputhje me kriterin e pavarësisë të shprehur në paragrafin 3.

2. Aty ku nevojitet të bëhet një dallim ndërmjet ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, "ndërmarrje e vogël" përkufizohet si një ndërmarrje që:

- ka më pak se 50 punonjës dhe
- ka ose,
një xhiro vjetore që nuk kalon 7 milionë Euro, ose
një bilanc vjetor që nuk kalon 5 milionë Euro
- është në përputhje me kriterin e pavarësisë të shprehur në paragrafin 3.

3. Ndërmarrje të pavaruara janë ato, 25% ose me shumë e kapitalit ose e të drejtës së votës të të cilave nuk zotërohen nga një ndërmarrje, ose bashkarisht nga disa ndërmarrje, që nuk përputhen me përkufizimet e një NVM-je ose një ndërmarrjeje të vogël, cilado të zbatohet. Ky prag mund të kalohej në dy rastet e mëposhtme:

- nëse ndërmarrja zotërohet nga korporata të investimeve publike, kompani me risk të lartë ose investues institucioni, me kusht që të mos ushtrohet kontroll mbi ndërmarrjen si individualisht ashtu edhe në grup,

- nëse kapitali është i shpërndarë në mënyrë të tillë që nuk është e mundur të përcaktohet se kush e zotëron ndërmarrjen dhe nëse kjo e fundit deklaron që mund të prezumojë ligjërisht që nuk zotërohet në 25% të saj ose më tepër nga një ndërmarrje, ose në bashkëpunim nga disa ndërmarrje, të cilat janë jashtë kuptimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ose ndërmarrjes së vogël, cilado qoftë e zbatueshme.

4. Në llogaritjen e pragjeve të përmendur në paragrafet 1 dhe 2, është e nevojshme të bashkohen statistikatat përkatëse për ndërmarrjen përfituese dhe për të gjitha ndërmarrjet që kjo kontrollon në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë duke zotëruar 25% ose më tepër të kapitalit ose të të drejtës së votës.

5. Aty ku nevojitet të dallohen mikrondërmarrjet nga ndërmarrje të vogla dhe të mesme të tjera, të parat përkufizohen si ndërmarrje që kanë më pak se 10 punonjës.

6. Nëse, në datë e bilancit të fundit, një ndërmarrje tejkalon ose bie nën pragun e numrit të punonjësve ose tavanëve financiare, kjo rezulton në fitimin ose humbjen e statusit si një "ndërmarrje e vogël dhe e mesme", "ndërmarrje e mesme", "ndërmarrje e vogël" ose "mikrondërmarrje" vetëm nëse ky fenomen përsëritet gjatë dy vjetësh financiarë të njëpasnjëshëm.

7. Numri i personave të punësuar përputhet me numrin e njësisve vjetore të punës (NJVP), që do të thotë, numrin e punonjësve të punësuar me kohë të plotë gjatë një viti me punonjësit me kohë të pjesshme dhe punonjësit sezonalë si një fraksion i NJVP-ve. Viti i referimit për vlerësim është ai i periudhës kontabël të miratuar të fundit.

8. Pragjet totale të xhiros dhe bilancit janë ato të periudhës kontabël 12 mujore të miratuara të fundit. Në rastin e ndërmarrjeve të reja llogaritë e të cilave nuk janë miratuar ende, pragjet që zbatohen duhet të rezultojnë nga një përllogaritje e besueshme e kryer gjatë vitit financiar.'

SHTOJCA II

Formulari i informacionit përmbledhës që duhet dhënë kurdo që të zbatohet një skemë ndihme që përjashtohet nga kjo rregullore dhe kurdo që një ndihmë individuale, e përjashtuar nga kjo rregullore, fitohet jashtë çdo skeme ndihme

Informacion përmbledhës për ndihmën shtetërore të dhënë në përputhje me Rregulloren e Komisionit (KE) 68/2001

Informacion përmbledhës për t'u plotësuar	Komente shpjeguese
Shteti Anëtar	
Rajoni	Jepni emrin e rajonit nëse ndihma jepet nga një autoritet joqendror
Titulli i skemës së ndihmës ose emri i shoqërisë tregtare që përfiton ndihmë individuale	Jepni emrin e skemës së ndihmës ose, në rastin e ndihmës individuale, emrin e përfituesit Në rastin e dytë, nuk nevojitet raporti vjetor pasardhës!
Baza ligjore	Jepni referencën e saktë ligjore kombëtare për skemën e ndihmës ose ndihmën individuale
Shpenzimet vjetore të planifikuara sipas skemës ose shuma totale e ndihmës individuale që i jepet shoqërisë tregtare	Shumat duhet të jepen në Euro ose, nëse është e zbatueshme, në valutën kombëtare. Në rastin e një skeme ndihme: jepni shumën totale vjetore të fondit të

	<p>miratuar në buxhet ose humbjen fiskale të përlogaritur në vit për të gjitha instrumentat e ndihmës që janë pjesë e skemës.</p> <p>Në rastin e ndihmës individuale: Jepni shumën totale të ndihmës/humbjen fiskale. Nëse duhet, jepni gjithashtu për sa vjet do të paguhet ndihma në këste ose në sa vjet do të pësohet humbje fiskale.</p> <p>Për garanci në të dy rastet, jepni shumën (maksimale) të huave të garantuara</p>
Intensiteti maksimal i ndihmës	Jepni intensitetin maksimal të ndihmës ose shumën maksimale të ndihmës për çdo artikull të vlefshëm
Data e zbatimit	Jepni datën në të cilën mund të jepet ndihma sipas skemës ose ndihma individuale
Kohëzgjatja e skemës ose ndihmës individuale	Jepni datën (vitin dhe muajin) deri në të cilën ndihma mund të jepet sipas skemës ose në rastin e ndihmës individuale dhe, nëse duhet, datën e planifikuar (viti dhe muaji) të pagesës së kështit të fundit
Qëllimi i ndihmës	Në rastin e ndihmës për trajnim, jepni nëse trajnimi është i përgjithshëm ose specifik.

Informacion përmbledhës për t'u plotësuar	Komente shpjeguese
<p>Sektori/sectorët ekonomikë të përfshirë</p> <p><input type="checkbox"/> Të gjithë sektorët</p> <p>Ose</p> <p><input type="checkbox"/> Bujqësia</p> <p><input type="checkbox"/> Peshkimi dhe Akuakultura</p> <p><input type="checkbox"/> Nxjerrja e qymyrgurit</p> <p><input type="checkbox"/> E gjithë industria e prodhimit</p> <p>Ose</p> <p><input type="checkbox"/> Çeliku</p> <p><input type="checkbox"/> Ndërtimi i anijeve</p> <p><input type="checkbox"/> Fibrat sintetike</p> <p><input type="checkbox"/> Automjetet</p> <p><input type="checkbox"/> Prodhim tjetër</p> <p><input type="checkbox"/> Të gjitha shërbimet</p> <p>Ose</p> <p><input type="checkbox"/> Shërbime të transportit detar</p> <p><input type="checkbox"/> Shërbime të tjera transporti</p> <p><input type="checkbox"/> Shërbime financiare</p> <p><input type="checkbox"/> Shërbime të tjera</p> <p>Komente:</p>	Zgjidhni nga lista, sipas rastit
Emri dhe adresa e autoritetit dhënës të ndihmës	
Informacion shtesë	

SHTOJCA III

Formulari i raportit periodik që i mundësohet Komisionit

Formati i raportimit vjetor për skemat e ndihmës të përjashtuara sipas një rregulloreje përjashtuese në grup të miratuar në zbatim të nenit 1 të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 994/98

Shtetet Anëtare janë të detyruara të përdorin formatin e mëposhtëm për detyrimet e tyre raportuese drejtuar Komisionit sipas rregulloreve përjashtuese në grup të miratuara në bazë të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 994/98

Raportet duhet të mundësohen gjithashtu në formë elektronike.

Informacioni i nevojshëm për të gjitha skemat e ndihmës të përjashtuara sipas rregulloreve përjashtuese në grup të miratuara në zbatim të nenit 1 të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 994/98

1. Titulli i skemës së ndihmës

2. Rregullorja përjashtuese e Komisionit e zbatueshme

3. Shpenzime

Statistika të veçanta duhet të mundësohen për çdo instrument të ndihmës brenda një skeme ose ndihme individuale (p.sh. grante, hua të buta, etj.). Statistikat duhet të shprehen në Euro ose, nëse është e zbatueshme, në valutën kombëtare. Në rastin e shpenzimeve fiskale, duhet të raportohen humbjet fiskale vjetore. Nëse nuk disponohen statistika të sakta, humbje të tilla mund të përlogariten afërsisht.

Statistikat e shpenzimeve duhet të mundësohen sipas kushteve të mëposhtme:

Për vitin në shqyrtim jepni të ndara për secilin instrument brenda skemës së ndihmës (p.sh. grante, hua të buta, garanci, etj.):

3.1. shumat e angazhuara, (me përlllogaritje) humbjet fiskale ose të ardhura të tjera të humbura, të dhëna për garancitë, etj. për projekte të reja me mbështetje. Në rastin e skemave të garancisë, duhet të mundësohet shuma totale e garancive të reja të shpërndara.

3.2. pagesat aktuale, (me përlllogaritje) humbjet fiskale ose të ardhura të tjera të humbura, të dhëna për garancitë, etj. për projekte të reja dhe aktuale. Në rastin e skemave të garancisë, duhet të mundësohen si vijon: shuma totale e garancive të papaguara, e ardhura prim, rikthimet, dëmshpërblimet e rimbursuara, rezultati operativ i skemës sipas vitit nën shqyrtim;

3.3. numri i projekteve të reja me mbështetje;

3.4. numri total i përlllogaritur i punëve të krijuara ose të mbajtura nga projektet e reja (nëse duhet);

3.5. shuma totale e përlllogaritur e investimeve të ndihmuara nga projektet e reja

3.6. ndarja rajonale e shumave sipas pikes 3.1 ose sipas rajoneve të përkufizuara në nivelin e dytë të NUTS-së [1] ose më ulët ose rajoneve sipas nenit 87 pika 3 germa (a), rajoneve sipas nenit 87 pika 3 germa (c) dhe rajonet e pambështetura;

3.7. ndarja e shumave sipas sektorëve sipas pikes 3.1 në sektorë aktiviteti të përfituesve (nëse mbulohet më shumë se një sektor, jepni pjesën e secilit):

- bujqësia
- peshkimi dhe/ose akuakultura
- nxjerrja e qymyrgurit
- industria e prodhimit

Nga e cila:

- çeliku
- ndërtimi i anijeve
- fibrat sintetike
- mjetet motorike
- prodhim tjetër (ju lutem saktësoni)
- shërbime

Nga të cilat:

- shërbime të transportit detar
- shërbime të tjera transporti
- shërbime financiare
- shërbime të tjera (ju lutem saktësoni)- sektorë të tjerë (ju lutem saktësoni)

4. Informacion shtesë dhe komente

[1] NUTS-ja është nomenklatura e njësive territoriale për qëllime statistikore në BE.